

Banka Për Biznes, Zyra Qendrore në Prishtinë shpall konkurs për pozitën:

KONKURS

Specialist në Departamentin Ligjor (m/f)

Kualifikimet:

- Kualifikim universitar (fakulteti Juridik), preferohet kualifikim pasuniversitar;
- Provimi i Jurisprudencës (i preferuar);
- Së paku 2 vite përvojë në fushën juridike;
- Aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit, prezantimit dhe organizimit;
- Aftësi të përfaqësimit në raste gjyqësore;
- Njohuri në kornizën ligjore, në përpilimin e shkresave ligjore dhe në rregulloret e aplikueshme;
- Nivel i avancuar i gjuhës angleze dhe përdorimit të MS(e obliguar Word-i);
- I/e aftë të punojë në ekip si dhe në mënyrë të pavarur.

Përgjegjësitë:

- Asiston dhe ndihmon mbikëqyrësin direkt në funksionim të qeverisjes korporative të bankës;
- Bënë hulumtime ligjore me kërkesë të mbikëqyrësit direkt;
- Përcjell ndryshimet në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e aplikueshme;
- Përpilon shkresa të ndryshme për të gjitha fazat e procedurave gjyqësore;
- Zhvillon plane konkrete lidhur me rastet gjyqësore;
- Përgatit raportet në bashkëpunim me mbikëqyrësin direkt dhe bënë provizionimin e padive ndaj bankës duke respektuar afatet e procedurave dhe politikave në fuqi;
- Përpilon/rishikon kontratat me palë të treta në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat që ka banka;
- Komunikon me gjykata, autoritetet tjera publike, lokale, qendrore dhe palët tjera si dhe përfaqëson pranë gjykatave, organeve administrative, policisë, prokurorisë, institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare sipas autorizimeve të mbikëqyrësit direkt;
- Përpilon parashtrësia të ndryshme për procedurën administrative, gjyqësore dhe organe të tjera;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin direkt harton planet e veprimit ndaj klientëve në vonesë dhe ndërmarrjen e masave për inkasim;
- Përpilon dhe dorëzon në gjykata paditë, propozimet për përmbarrim të kolateralit, të debitorëve ndaj të cilëve fillon procedura gjyqësore, përpilon ankesa kundër vendimeve gjyqësore dhe vendimeve tjera administrative, harton parashtrësia, kallëzime penale dhe ndërmerr veprime të tjera juridike pranë organeve kompetente shtetërore;
- Bënë pagesat e taksave të nevojshme gjyqësore për aktivizim të lëndëve të dorëzuara në gjykata si dhe i prezanton bankës dëshmitë mbi pagesat e kryera;
- Mbanë evidencë lidhur me lëndët nëpër gjykata, fazën procedurale në të cilën gjenden, numrin e lëndëve të kryera, shumën e borxheve të përmbushura etj;
- Kryen punë të tjera të parapara me akte qeverisëse të bankës.

Procedura e aplikimit:

Plotësoni formularin për aplikim i cili gjendet në këtë link: <https://www.bpbbank.com/forma-e-aplikimit-per-punesim/>

Pas seleksionimit të dokumentacionit do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë.

Afati i aplikimit është deri me datë: **07.03.2019.**